



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 83/4 prot.

Tiranë, më 02.07.2019

**VENDIM**

**Nr.78, datë 02.07.2019**

**PËR  
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT  
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 75, DATË 01.08.2018,  
“MBI VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË LIGJSHMËRISË NË PROCEDURËN E  
LIRIMIT NGA SHËRBIMI CIVIL, NË KUADËR TË RISTRUKTURIMIT SI DHE  
GJATË PROCEDIMIT DISIPLINOR NDAJ NËPUNËSES \*\*\*\*\*”,**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraparak të Drejtorit të Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 75, datë 01.08.2018 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e lirimit nga shërbimi civil, në kuadër të ristrukturimit si dhe gjatë procedimit disiplinor ndaj nëpunëses \*\*\*\*\*”,

**KONSTATOVA SE:**

Nëpërmjet kërkesës të regjistruar me nr. 429 prot., datë 03.05.2018, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është vënë në dijeni, lidhur me pretendimet e kërkuesit \*\*\*\*\* , se ka pasur moszbatim të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, gjatë procesit të transferimit të përhershëm dhe më pas lirimit nga shërbimi civil, në kuadër të ristrukturimit të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Akredituara nga Bashkimi Evropian, si dhe gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore.

Në përfundim të hetimit administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin Nr. 75, datë 01.08.2018, “Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e lirimit nga

*shërbimi civil, në kuadër të ristrukturimit si dhe gjatë procedimit disiplinor ndaj nëpunëses \*\*\*\*\**, të Komisionerit. Në përmbajtjen e këtij vendimi është konstatuar, se akti administrativ nr.30/9 prot., datë 16.02.2018, i Komisionit disiplinor për ndërprerjen e ecurisë disiplinore dhe kalimin e shqyrtimit të saj pranë eprorit direkt, si dhe akti nr.30/10 prot., datë 16.02.2018, i Drejtorit të Përgjithshëm të AAPAA, për dhënien e masës disiplinore “*vërejtje*”, janë akte administrative të paligjshme.

Me përfundimin e afatit për zbatimin e detyrave të lëna në vendimin paralajmërues, është mbajtur një komunikim zyrtar i vazhdueshëm me institucionin dhe njësinë përgjegjëse (DAP), në lidhje me masat e marra prej tyre për rastin e punonjësës \*\*\*\*\*. Konkretisht, me shkresat nr. 4215 prot., datë 05.10.2018 dhe nr. 13/1 prot., datë 17.01.2019, të AAPAA, nr. 267/2 prot., datë 25.01.2019, të DAP dhe nr. 65 prot., datë 12.03.2019, të AAPAA, janë administruar aktet administrative që materializojnë zbatimin e vendimit paralajmërues, objekt verifikimi. Pasi u analizuan aktet e sipërpërmendura dhe dokumentacioni bashkëlidhur tyre, konstatohet se:

Me vendimin nr. 42/16, datë 05.10.2018, Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së Akredituar nga Bashkimi Evropian, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 30/10 prot., datë 16.02.2018, për dhënien e masës disiplinore vërejtje për punonjësën \*\*\*\*\*.

Në përmbajtjen e shkresës nr. 267/2 prot., datë 25.01.2019, të Departamentit të Administratës Publike, drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (*për dijeni: AAPAA*), rezulton se në Regjistrin Qendror të Personelit nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi për \*\*\*\*\*.

Pavarësisht faktit se, me gjithë kërkesat e vazhdueshme nga ana e Komisionerit, për të na vënë në dispozicion aktin e Komisionit Disiplinor për anulimin pjesërisht të vendimit nr. 30/9 prot., datë 16.02.2018, ky akt nuk është mundur të administrohet në dosje bashkë me aktet e sipërpërmendura, çmoj se qëllimi i vendimit paralajmërues është përmbushur pasi punonjësja nuk ka masë disiplinore në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 75, datë 01.08.2018, " *Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e lirit nga shërbimi civil, në kuadër të ristrukturimit si dhe gjatë procedimit disiplinor ndaj nëpunëses \*\*\*\*\**".
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr.75, datë 01.08.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet Agjencia e Auditimit të Programeve të Akredituara nga Bashkimi Evropian.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**